



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1102/12 Prot

Vlorë, më 28.07.2022

VENDIM
Nr. 30, datë 27.07.2022

PËR
MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER
PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR KLASA I-V" NGA 60 NË 120
KREDITE.

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 75, pika 6, Udhëzimit nr. 31, datë 29.01.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", kreu 3 pika 2-f, të VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", shkresës së MAS nr. 5280 prot, datë 28.09.2021 "Për riorganizimin sipas ligjit të AL të programeve të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë" dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1055 prot, datë 25.07.2022, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 27.07.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimit "Master profesional në mësuesi për arsimin fillor klasa I-V" deri më tani me 60 kredite, në 120 kredite duke filluar nga viti akademik 2022-2023.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Departamenti i Edukimit si dhe Drejtoria e Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije MAS.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF.AS.XHILIOLA AGARAJ

